

336.221.4(497.115)
338.23:336.22 (497.115)

SITEMIT FISKAL I KOSOVES KONFORM KËKRESAVE BASHKOHORE TATIMORE, TEKNIKAVE DHE METODAVE TE TATIMIT

Prof. Ass. Dr Gani Asllani*

Abstrakti:

Në këtë punim trajtohen disa nga çështjet bazike që shtrohen sot para ndërtimit të politikave fiskale dhe sistemit tatimor në funksion të zhvillimit ekonomik. Trendet e reja integruese ekonomike dhe orientimi drejt ekonomisë së tregut imonjone nevojën që sistemi tatimor të adaptohet me këto procese dhe ndihmon ato duke mbajtur rritje dhe zhvillim të qendrueshëm ekonomik. Për të arritur normë optimale të rritjes ekonomike duhet të ketë politika adekuate fiskale dhe të ekzistojë një tatimim optimal i cili do të zhvillojë sektorin fiskal (atë të hyrave dhe shpenzimeve publike). Si njëri nga faktorët më me ndikim në përcaktimin e treguesve makroekonomikë dhe llogaritjen e të ardhurave kombëtare sektori fiskal ndikon në zhvillimin e sektorve tjera të ekonomisë si sektori real, financiar dhe në përmirësimin e sektorit të këmbimit të huaj (jashtëm) dhe në menyrë direkte dhe indirekte në punësimin, investimet, konsumin, stabilitetin e çmimit, ulje të inflacionit, etj. Natyrisht, harmonizimi i sistemit tatimor të Kosovës me direktivat e Bashkimit Evropian duhet të kenë objektivat, qëllimet, efikasitetin, stabilitetin, gjithëpërfshirëjen dhe transparencën e politikave fiskale dhe sistemit tatimor si instrumenteve kryesor të saj.

Fjalet kuqe: Tatimi, sistemi tatimor, tretmani tatimor, teknikat tatimore.

1. Hyrje

Zhvillim ekonomik i një shteti nuk mund të imagjinohet dhe të bëhet realitet pa një politikë fiskale dhe sistem tatimor të mirëfilltë. Sistemi tatimor paraqet element të rëndësishëm të sistemit makroekonomik i cili duhet të sigurojë një bazë elementare fiskale që ka për qëllim të mbledhë të ardhura me të cilat mbulohen shpenzimet publike dhe shpenzimet tjera të parapara me ligj. Në këtë drejtim, Kosova pas përfundimit të luftës, filloi të ndërtojë politika tatimore të orientuar në

* Punon profesor dhe ud. Dekanin në Fakultetin Juridik në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, e-mail: ganasllani@hotmail.com.

ekonominë e tregut, të cilat politika përfshinë ndërtimin dhe implementimin e koncepteve moderne të taksimit. Ky sistem i tatimit është në përputhje me rregullat e Bashkimit Evropian dhe standardet më të avancuar ndërkombëtare. Shteti i Kosovës falë ndihmave dhe donacioneve ndërkombëtare ka arritur të përmbyllë fazën emergjente në mënyrë të suksesshme, fazën e krijimit të institucioneve, fazën e tranzicionit dhe tani po bënë përpjekjeve për ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe integritetit të saj me ekonomitë e tjera në rajon dhe më gjerë. Natyrisht, se për themelimin e institucioneve plotësisht të reja si dhe kompletimi i tyre me legjislacionin adekuat, është dashur kohë dhe dije, veçanërisht çështje e ndërlikuar ishte ajo e ndërtimit të politikës fiskale cila do të këtë dy role kryesore: atë të grumbullimit të të hyrave si dhe aspektin e zhvillimit ekonomik. Që nga mbarimi i vitit 2004, Kosova me të hyrat e saj ishte në gjendje të financonte nevojat e domosdoshme të administratës së saj publike dhe transfereve sociale, me tendencë të vazhdueshme të rritjes së të hyrave buxhetore dhe financimin e projekteve në bazë të prioritetëve.¹ Kosova ka ndërtuar dhe vazhdon të ndërton një sistem tatimor të thjeshtë, me aplikim të normave tatimore të ulëta dhe me një regjim të lirë të tregtisë (pa barriera dhe kufizime doganore), është prej vendeve me liberale në regjion, gjë që mundëson kycje më të shpejtë në integrimet që pasojnë.² Kjo politikë e tillë do të imponon nevojën në përgatitje më të shpejtë të bizneseve për hyrje në konkurrencë të lirë me ekonomitë e tjera më konkurrencte dhe me të edhe rritje të produktivitetit të punës. Kjo rritje ekonomike do të përcillet edhe me qëndrueshmëri buxhetore dhe ekuilibrim të të hyrave me shpenzimeve publike. “Qëllimi kryesor i çdo sistemi fiskal është që të siguroj të hyra me të cilat do të mbështet shpenzimet publike.³ Prandaj, shkalla e tatimeve brenda vendit varet nga vëllimi i shpenzimeve qeveritare”. Pa mëdyshje si në rritje dhe zhvillimin ekonomik përpos politikës tatimore dhe instrumenteve të saja ndikojnë edhe një numër i madh i politikave dhe faktorëve të tjerë të ndërlidhur në mes veti si; çfarë programesh qeveritare ekzistojnë për tërheqjen e investimeve të huaja, ku qëndron roli i privatizimit në zhvillimin ekonomik, sa ekziston partneritet në mes qeverisë dhe sektorit privat dhe në çfarë shkallë është i pranishme, sa është e zhvilluar politika bankare dhe e kreditorëve, cilat janë mundësitë e Kosovës për qasje në fondet strukturore të BE-së, çështjet e infrastrukturës, resurseve, situatës politike dhe sociale, korrupsionit e tjera. The fiscal system to us is relatively new, a system that is based on direct and indirect taxes. The capacity building has started since 1999 with the Regulation on customs, then in 2001 begin to apply and other taxes as tax untried (May 2000), VAT (May 2001), income tax (1 April 2002), property tax (June 2003), corporation tax (December 2004) on the road tax (March

¹ Institute for Development Research “Riinvest” Prishtinë, 2005

² G. Asllani, Scientific Paper, "The impact of fiscal policy on economic development", Romania, Danubius University Press Home, vol. No. 7, 2011

³ P. Jurkovic (1991). Projektimi një sistemi tatimor për të nxitur ndryshim strukturor, ” Roli i reformës tatimore në Ekonomitë e Evropës Qendrore dhe Lindore, OECD. Marek Dubrowski, Magdalena Tomczyńska, reformat tatimore në ekonomitë në tranzicion, Warshavë, viti 2001, faqe 6.

2005) in royalties taxes and steadily and the application of other non-tax revenues. Despite the lack of sufficient official statistics, based on estimates and analyzes of local foreign institutions we can draw some conclusions acceptable that affect economic development, its level and future fiscal projections.⁴ In General, the assessments made of the movements of the main macroeconomic indicators in the period 2002- 2014 shows a trend of continuous symbolic improvement of these indicators. It is important to consider that how fiscal policy affects economic growth, as the economy is burdened with the taxes, share in GDP, share of income and expenditure in GDP, what is the share of tax types in total revenues, experience in other countries that are in a higher stage of development, and finally on the basis of these data are seen next steps of action. There is a need to improve the database of macroeconomic and fiscal indicators.

2. Kërkesat bashkëkohore që parashtrihen sot në fushën e tatimit

Njohja teorike, hulumtimet empirike dhe përvoja praktike në fushën e tatimit në një anë, si dhe lëvizjet integruese në përmasa të gjera në anën tjetër, në disa dekadat e fundit kanë pasur ndikim jo të vogël në ndryshimin e sistemit tatimor si dhe masat e politikës ekonomike, gjegjësisht në kërkesat të cila në kushtet bashkëkohore parashtrihen para sistemit tatimor dhe politikës ekonomike. Po i përmendim disa më të rëndësishmet:⁵

Harmonizimi i tatimeve- me qëllim që sa më mirë dhe më shpejt të realizohen qëllimet të cilat i ka formular bashkësia ekonomike për integrim të plotë, është e nevojshme, përveç të tjerave, sa më shumë ti harmonizojnë sistemet tatimore dhe masat e politikës ekonomike. Përvoja ka treguar, që më qëllimi të funksionimit të suksesshëm të atyre bashkësive nuk është e domosdoshme të unifikohen sistemet tatimore dhe politikat tatimore, por për realizimin e qëllimeve të proklamuar është e mjaftueshme që ato sisteme dhe ato politika sa më shumë të afrohen, që sa më shumë të harmonizohen, me fjalë të tjera që të harmonizohen aq dhe ashtu, që dallimet e mbetura të mos jenë pengesa për realizimin e katër lirive themelore; realizimin lirisë së lëvizjes së njerëzve, mallit, kapitalit dhe shërbimeve. Në drejtim të harmonizimit të sistemeve tatimore dhe politikës tatimore më së shumti ka bërë Bashkësia Evropiane. Shtete anëtare të saja në tërësi jo vetëm që i kanë harmonizuar, por edhe e kanë unifikuuar sistemin e doganës, dhe janë bërë hapa të mëdhenj në harmonizimin e rregullave me të cilën rregullohet materia e tatimit të qarkullimit si dhe aplikimin e tatimeve të veçanta në qarkullim (akcizës). Mirëpo, edhe pse të gjitha vendet anëtare të BE në sistemet e tyre tatimore kanë ndërtuar tatimin në qarkullim e përgjithshëm në formë të TVSH-së, ende në mes tyre ekzistojnë dallime jo të vogla në numrin dhe lartësinë e normave

⁴ IMF, World Bank, MF, CBK, and the other NSO.

⁵ Dr. Barbara Jelicic, Financat Publike, Informtor, Zagreb, viti 1997, faqe 176-182

tatimore, përjashtimeve tatimore si dhe pjesëmarrjes së TVSH-së në të hyrat e përgjithshme tatimore të vendeve të caktuar. Sipas shembullit të BE-së, TVSH-në në sistemet e tyre tatimore i kanë ndërtuar edhe shumë shtete të tjera: shtetet që dëshirojnë të jenë anëtare të BE-së, shtetet të cilat kanë marrëdhënie tregtare të zhvilluara me shtetet e BE-së, shtetet në tranzicion të cilat me reformën e sistemit të tyre të tatimit tentojnë sa më shpejt dhe suksesshëm ta adaptojnë këtë lloj të tatimit në konsum. Kosova nga viti 2001 aplikon TVSH, konform direktivave të BE-së, dhe konsiderohet si njëri nga tatimet me të rëndësishme në strukturen e sistemit tatimor.

Tatimet neutrale- shfrytëzimi i tatimit si instrument i politikës ekonomike të shtetit, në praktikë nuk është dëshmuar. Praktika pa hamendje ka treguar që shteti me udhëheqje të dobët, veprimi i tij në ekonomi është inferior në krahasim me mekanizmat e tregut. Për shkak të ndikimeve të padëshiruara ekonomike të tatimit, gjegjësisht për shkak të kërkesave që shteti sa më pak të ndikojë në sjelljen e obliguesve tatimor, gjithnjë e më shumë janë të zëshme kërkesat që roli i tatimeve të kufizohet në realizimin e qëllimeve fiskale, dhe se rreziku i sjelljes së vendimeve afariste tu lehet vet ndërmarrësve, gjegjësisht të përjashtohet mundësia që shteti me masa të politikës ekonomike të ndikojë në vendimet afariste të obliguesve tatimor. Në literaturën financiare kufizimi i rolit të tatimeve në mbledhjen e mjeteve me të cilat plotësohen të dalat nga komponentët e tyre, njihet si tatim neutral. *“Teorikisht tatimi neutrale është nëse nuk ndryshon vendimet e tregut, gjegjësisht përzgjedhjen e subjekteve në treg”.*

Zvogëlimi i ngarkesës tatimore- dekadave të fundit të shekullit të kaluar gjithnjë e më të zëshme ishin kërkesat e teorikeve, politikanëve, bizneseve, interesat e ndryshme të shoqatave, e opinionit të gjerë për zvogëlimin e ngarkesës tatimore, gjegjësisht për ndërprerjen e pjesëmarrjes së tatimeve në prodhimin shoqëror. Kërkesa për shtet “kursimtar” për zvogëlim, gjegjësisht kufizimin e ndonjë detyre nga kompetenca e shtetit, për zvogëlimin e ngarkimit të ekonomisë, më qëllim që të nxitet prodhimtaria, rritet punësimi, zvogëlohet inflacioni e tjera, janë të pranishme në të gjitha shtetet bashkëkohore. Kriteret të cilat anëtarët e BE-së duhet që në bazë të marrëveshjes së Mاستritit të plotësojnë për tu bërë anëtarë në Unionin monetar, veçanërisht zvogëlimi i deficitit në 3% të të hyrave dhe hyrjes së tërësishme me borxhe deri në 60% të prodhimit shoqëror, në afat të gjatë do të ndikojnë edhe në ndaljen e rritjes së ngarkesës tatimore jo vetëm në BE-në por edhe në shtetet tjera bashkëkohore.

Thjeshtësia në tatim- tentimi që tatimi të bëhet sa më i thjeshtë, që obliguesi tatimor sa më lehtë të gjendet në rregulloret tatimore, që numri i llojeve tatimore të zvogëlohet ashtu që nga sistemi tatimor të hiqen të ashtuquajturat tatimet “inferiore” që materia tatimore të jetë e rregulluar në mënyrë më precize me qëllim që të përjashtohet mundësia e interpretimit të tyre nga ana e zyrtarëve tatimor

gjegjesisht të pengohet vet dëshira në aplikimin e rregullave tatimore, është pasojë logjike e demokratizimit gjithnjë e më të madh të shtetit.⁶ Obliguesi tatimor jo vetëm që dëshiron, por edhe kërkon që obligimet e tyre të jenë të qarta, të kuptueshme, dhe të përcaktuara pa hamendje. Në kohën e re janë rritur kërkesat që sistemet tatimore të jenë sa më të thjeshta dhe të ketë tatim optimal. Thjeshtësia në tatimi me zvogëlimi i ngarkesë tatimore përbën reformën më të mirë tatimore.

Përparësitë e tatimit të konsumit në raport me tatimin e të ardhurave- në rrethet e dijes gati që gjysmë shekulli diskutohet për atë se, a është konsumi bazë më i përshtatshme e tatimit, apo të ardhurat. Theksohet se, që tatimi i konsumit është më i drejtë se sa i të ardhurave, se mundësia e evazionit fiskal është më i vogël me rastin e tatimit të konsumit dhe se është logjike të tatimohet konsumi se sa të ardhurat. Në favor të tatimit në konsumit theksohet ajo, se njerëzit punojnë edhe krijojnë të ardhura jo për atë që ti kenë, por për atë që ti konsumojnë dhe ashtu ti kënaqin nevojat e tyre. Orientimi në tatimin e konsumit nxitë kursimin, me vet këtë ndikon në investime, dhe nga kjo mundëson krijimin e vendeve të reja të punës dhe në përgjithësi në zhvillimin ekonomik. Ka edhe mendime, që orientimi në tatimin e konsumit është më shumë në harmoni me parimin e pagesës së tatimit sipas fuqisë ekonomike. Në përparësinë e padyshimtë të lidhur me tatimin konsumit theksohen edhe disa dobësi të caktuar të orientimit në rolin e përmendur të tatimit të konsumit në raport me të ardhurat. Ashtu si personat ekonomik më të dobët pjesën më të madhe të ardhurave të tyre e konsumojnë, tatimi i konsumit ngarkon më shumë të varfëritë gjegjesisht i bie në pozitë më të favorshme të pasurit.

Drejtësia në tatim- Detyrë afatgjate që parashtrohet para kreatorëve të sistemit tatimor është shpërndarja e barabartë e ngarkesës tatimore, realizimi sa më i madh i barazisë horizontale dhe vertikale, gjegjesisht i barazisë sa më të madhe në tatim. Barazia në tatimi është parim më i lartë në të cilën duhet të mbështete tatimi në të ardhmen.

3. Teknika e tatimit e të ardhurave

Procedura e tatimit e të ardhurave mundet të kryhet në bazë të njohurive për madhësinë ekzakte e të hyrat dhe e të gjitha atyre të dhënave të cilat janë relevante për shkallëzimin e tatimit në të ardhura, si dhe aplikimin e teknikave të tjera, të cilat nuk mbështeten në të dhënat për llojin dhe madhësinë e elementeve të rëndësishëm për ngarkesën tatimore të obliguesit tatimor konkret.

3.1. *Tretmani tatimor i personalizuar – individual*

⁶ Stiglit J Schonfelder, Financat , Vjenë, viti 1989, faqe. 515-516

Në kuptim që madhësia e borxhit tatimor të ndonjë obliguesi tatimor përcaktohet në bazë të atyre treguesve të cilët janë të lidhur për personin konkret si obligues tatimor, është e mundur të kryhet përmes dy teknikave apo metodave dhe atë:

-Shkallëzimi i tatimit në të ardhura në bazë të lajmërimit vetanak të obliguesit tatimor. Në procedurën e shkallëzimit të tatimit, obliguesi i tatimit në të ardhura do të jetë, në parim, i thirrur që zyrës së autorizuar ti ven në disponim informatat relevante për caktimin e borxhit të tij tatimor, me theks të veçantë që ti bëj transparente të gjitha informatat dhe dëshmitë për lehtësirat tatimore në të cilat ka të drejtë, si dhe për të gjitha dëshmitë të cilat i lënë zyrës tatimore. Këtë obliguesi tatimor do ta bëj me dërgimin e deklaratës tatimore me kohë, në mënyrë dhe në vendin ashtu si është e përcaktuar me rregulla të cilat atë materie e rregullojnë. Vet procedura e shkallëzimit mund të kryhet ashtu, që borxhi tatimor ta llogaritë vet obliguesi tatimor, i cili atë do ta bën ashtu që në përputhje me ligj dhe me nene të përcaktuara do ta llogaritë bazën tatimore, do të llogaritë me ligj zbritjet e lejueshme dhe ashtu të vije deri te të dhënat për ngarkesën e tij tatimore, dhe në bazë të saj të paguan tatime. Shërbimi financiar ka në këtë variante mundësi të kontrollit dhe korrektimit të shkallëzimit të cilin e ka bërë vet obliguesi tatimor. Nëse shkallëzimi i tatimeve e kryen shërbimi financiar gjegjësisht shërbimi tatimor, ai atë do ta bëjë gjithashtu në bazë të të dhënave të cilat ja bartë obliguesi tatimor, por në këtë rast ato të dhëna janë vetëm mbulesë për llogaritjen e borxhit tatimor të cilin do ta kryej shërbimi tatimor.

-Tatimi me zbritje- shikuar teknikisht nuk e paguan vetëm obliguesi tatimor, por ai person (fizik apo juridik) tek i cili obliguesi tatimor realizon të ardhurat e tij. Në raport me metodën e mëparshme të llogaritjes dhe pagesës së tatimit në të ardhura, kjo ka mangësi e cila shihet në atë se tatimimi kryhet në mënyrë të thjesht i cili nuk lejon marrjen në konsiderim vetitë vetanake gjegjësisht rrethanat e obliguesit tatimor.

Nga ana tjetër duhet të tregohet në përparësitë të cilat metoda e pagesës së tatimit në të ardhura sipas zbritjeve ka në raport me metodën e deklarimit vetanak, dhe ato shihen në atë se:

- a) është i vështirësuar apo minimizuar mundësia e evazioni tatimor,
- b) të hyrat e mbledhura nga tatimi në të ardhura rrjedhin në llogari në mënyrë të vazhduar,
- c) elasticiteti i tatimit në të ardhura rritet dhe
- d) mundësia e disponimit pas tatimimit të mjeteve të mbetura për obliguesin tatimor është më e lehtë, e përshtatshme, pasi që koha e arritjes së të ardhurave dhe koha e pagesës së tatimit nga ato të ardhura përshtaten d.m.th bien në kohë të njëjtë (e ashtuquajtura pay-as-you-earn-system).⁷

⁷ www.wiklipedia.com ; Sistemi "Pay As You Earn (PAYE)" është një metodë e pageses së tatimit mbi të ardhurat dhe kontributet kombëtare të sigurimeve. Punëdhënësi i zbrit tatimet dhe kontributet kombëtare të sigurimeve nga paga para se të paguan paga punëmarresit.

3.2. Metodatat e pagesës së tatimit të cila nuk nisen nga individualizimi dhe personalizimi

Tatimi paushall- tatimi në të ardhura nuk do të paguhet gjithëherë në shumën e cila do ti përgjigjet rezultatit të saktë të mbledhjes të të gjitha elementeve të cilat e përbejnë të ardhurën nga të cilat zbriten të gjitha elementet e parapara, me qëllim që ashtu të fitohet baza reale tatimore. Në raste të caktuara obligimit tatimor, do të lejohet pagesa e tij me të ashtuquajturit tatim paushall. Kjo variant e pagesës së tatimeve në të ardhura si e arsyeshme aplikohet në ato raste, kur koha, shpenzimet dhe punët janë të lidhura me llogari ekzakte të ngarkesës tatimore konkrete të obliguesit të caktuar tatimor në raport të ndërsjellë me shumën të cilën duhet ta paguaj.

Tatimi mesatar- në disa raste nuk do të duhet që borxhi tatimor të llogaritet në mënyrë që ai ti përgjigjet parimit të pagesës së tatimit sipas fuqisë ekonomike, dhe për shkak të natyrës së tyre të veçantë ato nuk duhet të lajmërohen në tërësi apo pjesërisht të gjitha ato elemente të cilat për caktimin e fuqisë ekonomike të saj janë relevante. Në këtë rast do të aplikohet tatimi mesatar, i cili këtu përmendet vetëm si ide në favor të gjetjes së tatimit “ideal” të tatimit të të ardhurave. Ideja deri tani ka mbetur vetëm si model teorik, aplikimi i së cilës mund të pasoj vetëm pasi të largohen ende deri tani problemet e pazgjidhura të cilat me këtë metodë janë të lidhura.

Tatimi i sheshtë (Flat Tax)- tatimi përmes aplikimit të tarifës progresive nuk është i liruar nga numër jo i vogël i problemeve teknike, për shkak të saj tatimi në të ardhura është bërë njëra nga format tatimore më të komplikuar të ndërtuar në sistemin tatimor të shteteve bashkëkohore. Për këtë shkak, në vitet e fundit, janë propozuar zgjidhje të ndryshme në reformat e tyre në të cilën një nga kërkesat më të theksuara ka qenë thjeshtësia e tatimit me aplikim të këtij tatimi. Një nga ato propozime meriton vëmendje të veçantë. Behet fjale për të ashtuquajturin Flat Tax apo Flat Tax Rate, gjegjësisht tatimit linear të të ardhurave, dhe tentimin me serioz që kjo ide në praktike të realizohet është bërë në SHBA me 1986 në ligjin e reformës së tatimit në të ardhura. Flate tax rate, e karakterizon norma tatimore konstante marginale. Mirëpo, duke marrë për bazë atë dhe krahas me norma të tilla të propozuara edhe shumë dhënie të liruara (si subvencionet, si dhe bëhet fjalë për tatimin negativ në të ardhura) për një mori të të ardhurave, kjo formë e tatimit në të ardhura mbetet ende progresive, vetëm se në këtë rast bëhet fjalë për progresionin indirekt. Sipas kësaj, në vend të normave marginale rritëse në sistemin e tatimit linear në të ardhura, të ardhurat janë të definuar shumë më përfshirëse, pasi që me rastin e tatimit dhe aplikimin e tyre janë të eliminuar forma të llojllojshme dhe të numërta të lehtësirave tatimore.

4. Përfundimi

Ndërtimi i sistemit fiskal dhe krijimi i politikave fiskale duhen të përshtaten rrjedhave ekonomike të vendit si dhe më gjerë. Kosova ka hyrë në fazën e reformave të politikave fiskale dhe këto reforma duhet të vazhdojnë ato me një maturi të madhe. Këto reforma duhet të adaptohen me praktikave fiskale të vendeve tjera të rajonit si dhe me trendet tatimore të Bashkimit Evropian. Reformat tatimore përfshijnë ndërrimin e politikës tatimore, modernizimin e administratës tatimore dhe njohjen me taksa të reja, veçanërisht të TVSH-në. Këto do përmirësojnë dhe krijojnë mjedis ekonomik më të mirë, njëkohsisht do thjeshtësojnë sistemin tatimor, eliminojnë tatimet e numërta të cilat japin rendimente të ulët. Në fund, zgjerimi i bazës tatimore dhe gjithëpërfshirja e obliguesve tatimor, caktimi i ngarkesës fiskale të përballueshme nga bizneset dhe tatimpaguesit e tjerë, zgjedhja e teknikave të tatimit dhe trajtimi i barabartë i tatimpaguesve, rritja e mbikëqyrjes dhe kontrollit e me të gjithë efikasitetin në inkasim si dhe përfillja e kërkesave tjera dhe trendeve bashkohore të tatimit në BE dhe më gjerë janë sfida të vazhdueshme të cilat shteti i Kosovës dhe institucionet që administrojnë tatimet duhet të kenë në konsideratë.

Referencat

- Bozidar Jelcic, *Shkenca mbi financat dhe drejta financiare*, Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore, Prishtinë 1985
- Bronchi, C. and A. Burns (2000), "The Tax System in the Czech Republic", OECD economics Department Working Papers, No. 245, OECD Publishing
- Brummerhoff Dieter, *Javne Financije*, Sedmo izdanje, Mate d.o.o Zagreb 2000
- Institute for Development Research "Riinvest" Prishtinë, 2005
- Jack M. Mintz: Growth and taxes, some implications for developing economies, page. 207. "Public Finance in Developing and Transitional Countries"
- Jurkovic P. (1991). Designing a tax system to promote structural change. The role of tax reform in Central and Eastern European Economies, OECD
- Musgrave, R. A. and Musgrave, P. B. 1989. *Public Finance in Theory and Practice*. 5th ed. New York: McGraw-Hill
- Tax Simplification for Jobs and Growth, Mark Gallagher and Ante Babic, 2005. Croatia
- The Past, the Future, and Modern Portfolio Theory. Harry Markowitz, "Portfolio Selection," *Journal of Finance* 7.1 (March 1952).

**THE FISCAL SYSTEM OF KOSOVO COMMENSURATE TO MODERN TAX
REQUIREMENTS, TAX TECHNIQUES AND METHODS**

PhD Gani Asllani

Abstract:

This paper covers some of the basic issues that are raised today before the establishing of the tax system and fiscal policy in the context of economic development. New integrated economic trends and orientation towards market economy enforce the need to be adopted the tax system with these processes and helps them keeping them up and sustainable economic development. To achieve optimal economic growth rate should be established adequate fiscal policy and optimal taxation that will develop the fiscal sector (public revenue and public expenditure). As one of the most influence factors in determination of macroeconomic indicators and calculation of national incomes, the fiscal sector affects in the development of other sectors of the economy as it is real sector, financial sector as well as improvement of the foreign exchange sector and directly and indirectly affects in employment, investments, consumption, price stability and cut the inflation. Naturally, the harmonization of tax system of Kosovo with European Union directives should have objectives, goals, efficiency, stability, and transparency comprehensiveness fiscal policies and tax system as its main instruments.

Key words: Tax, tax system, tax treatment, tax techniques.